

Prishtinë: 24.06.2007

Kodi i ZRrE-së: D_057_07

Nr. i Referencës: ERO/CPD_R_24_06_07

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 4.7, nenin 16.1, nenin 6.1 dhe nenin 24.1 të Rregullit mbi Shkycjet dhe Rikycjet e konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë;
4. Ankesën e bërë nga konsumatori në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në Zyrën e Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të regjistruar me 20.02.2007 me numër regjistrimi 43/02.2006;
5. Njoftimin për shkycje të datës 15.07.2005;
6. Njoftimin për shkycje të datës 07.10.2005;
7. Urdhëresa për shkycjen e parë të datës 28.10.2005 dhe urdhëresa për shkycjen e dytë të datës 14.11.2005;
8. Kontratën për Rregullimin e Borxhit të datës 18.11.2005;
9. Njoftimin për shkycje të datës 28.04.2006;
10. Urdhëresën për shkycje të datës 21.06.2006 (fotot e paraqitura);
11. Njoftimin për shkycje të datës 28.09.2006;
12. Urdhëresën për shkycje të datës 27.10.2006 (fotot e paraqitura);
13. Njoftimin për shkycje të datës 08.01.2007;
14. Përgjigjen e KEK-ut të datës 14.02.2007 në ankesën e konsumatorit për gjobat e shkycjes nga rrjeti elektrik;
15. Urdhëresën për shkycje të datës 23.02.2007 (fotot e paraqitura);
16. Nenin 20.4, nenin 20.3 dhe 20.9 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës Nr. 02/L-47;

Në mbledhjen e mbajtur më datë 21.06.2007 nxjerrë këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Z. Sejdi Sejdiu (konsumator komercial – 7/01) për arsyet e paraqitura në Arsyetimin e këtij Vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar KEK-ut – Divizionit të Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë – Distriktit në Gjilan ka kontestuar faturimin e gjobave (dënimeve) të shkycjes të ngarkuar nga KEK-u.
2. Faturimi i KEK-ut për gjobat për shkycje është bërë si pasojë e borxhit që konsumatori kishte ndaj KEK-ut.

3. Më datë 14.02.2007 Divizioni i Furnizimit në Distriktin e Gjilanit (KEK) ka dhënë përgjigje konsumatorit në ankesën e tij, duke e refuzuar dhe informuar konsumatorin për të drejtat e tij në apelimin e përgjigjes së KEK-ut në Zyrën e Rregullatorit për Energji.
4. Me datë 20.02.2007 konsumatori apelon përgjigjen e KEK-ut në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE lidhur me faturimin e gjobave për shkyçje si dhe parapagimin për RTK. Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE ka regjistruar ankesën e konsumatorit në regjistrin e ankesave me nr. 43/02.2007.
5. Konsumatori ka kontestuar gjobat për shkyçjen e parë me datë 28.10.2005, 21.06.2006, 27.10.2006 dhe 23.02.2007 dhe shkyçjen e dytë (konsumatori ka bërë kyçje pa autorizimin nga KEK-u me çka kjo kyçje e konsumatorit konsiderohet kyçje ilegale) me datë 14.11.2005 si dhe ka kontestuar parapagimin për RTK
6. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRrE-së, përgjigjen e KEK-ut dhënë konsumatorit, analizimin e dëshmive të paraqitura dhe duke u bazuar në Kornizën Ligjore të Aplikueshme në Kosovë, lidhur me ankesën e konsumatorit për kontestimin ndaj gjobave të shkyçjes dhe kontestimin ndaj parapagimit për Radio Televizionin e Kosovës konstaton se nga ana e KEK-ut janë zbatuar të gjitha procedurat e parapara. Për kontestimin ndaj gjobave të shkyçjes KEK-u ka zbatuar të gjitha procedurat e parapara në Rregullin mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë. Ndërsa sa i përket ankesës së konsumatorit për parapagimin për RTK, KEK-u ka zbatuar të gjitha pikat e parapara në Ligjin Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës. Përgjigja e KEK-ut dhënë konsumatorit lidhur me kontestet e lartpërmendura është në pajtim me legjislacionin në fuqi. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lartë DMK rekomandon Bordit të ZRrE-së të refuzoj ankesën e konsumatorit nr. 43/02 2007 e cila ankesë apelon përgjigjen e KEK-ut të datës 14.02.2007. Ankesa e konsumatorit duhet refuzuar ngase:
 - 6.1 KEK-u në rastin e konsumatorit Lokal Sejdi Sejdiu ka dhënë fakte të mjaftueshme me të cilat ka vërtetuar se Konsumatori nga Vitia është shkyçur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit që konsumatori kishte ndaj KEK-ut. Kjo dëshmohet edhe në njoftimet për shkyçje, urdhëresën për shkyçje.
 - 6.2 Përgjigja e KEK-ut për refuzimin e ankesës lidhur me faturimin për gjobat për shkyçje është bazuar në dispozitat e Rregullit për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.
 - 6.3 Në bazë të nenit 4.7 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë të Aprovuar me 24 Shkurt 2006 nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, ndërmarrja energjetike ka të drejtë të ngarkoj me tarifa për përgatitjen e njoftimeve të shkyçjes dhe rikyçjes dhe për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në përputhje me Tabelën e Çmimeve dhe Gjobave e cila është dhënë si shtojcë në këtë rregull.
 - 6.4 Në bazë të nenit 16.1 a) të Kapitullit 4 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë përpara shkyçjes ju jeni njoftuar nga KEK-u Divizioni i Furnizimit me anë të Njoftimi për Shkyçje, ku për përgatitjen dhe shpërndarjen e lajmërimeve (njoftimeve për shkyçje dhe/ose rikyçje) në përputhje me Tabelën e Çmimeve dhe Gjobave, gjoba juaj është 10.00 € plus TVSH, ku e gjitha është 11.50 €. Konsumatori ka marrë Njoftimet për Shkyçje me datë 15.07.2005, 07.10.2005, 28.04.2006, 28.09.2006 dhe 08.01.2007

- 6.6 Sipas nenit 6.1 të Rregullit mbi Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, ndërmarrja energjetike mund të shkycë konsumatorin i cili nuk paguan faturën e vet ose shumën siç përcaktohet në një marrëveshje pagimi të lidhur me ndërmarrjen energjetike brenda afatit përfundimtarë dhe sipas kushteve të përcaktuara në dispozitën e faturës ose pagesës në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Për shkycjet dhe rikycjet për ekonomi jo-familjare në përputhje me Tabelën e Çmimeve dhe Gjobave (Shtojca 1) ku edhe bënë pjesë ankesa juaj, gjoba është në shumën prej 100.00 € plus TVSH ku e gjitha është 115.00 €. Konsumatori sipas nenit të lartpërmendur është shkycur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit ndaj KEK-ut me datë 28.10.2005, 21.06.2006, 27.10.2006 dhe me datë 23.02.2007.
- 6.7 Sipas nenit 24.1 Rregullit mbi Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, një konsumator që kyç ose rikyç shërbimet elektrike pa autorizimin me shkrim prej ndërmarrjes energjetike, do të paguajë tatimet dhe gjobat tek ndërmarrja energjetike në shumën e përcaktuar në përputhje me Shtojcën 1 të Rregullit për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë. Rikycjet e paligjshme të konsumatorëve të regjistruar të godinave pas shkycjes së tyre nga ndërmarrja energjetike për konsumatorët jo-shtëpiak (7/02) është 300 € plus TVSH-ja, pra e gjitha prej 345 €. Konsumatori është rikyçur në rrejt pa autorizimin e ndërmarrjes me datë 14.11.2005, andaj sipas nenit të lartpërmendur është shkycur prapë nga rrjeti për shkak të veprimit jo të lejuar të konsumatorit dhe është gjobitur me shumën e paraparë në Shtojcën 1 të Rregullit e cila shumë është 345 €.
- 6.8 Ndërsa sa i përket ankesës së konsumatorit në lidhje me parapagimin për Radiotelevizionin e Kosovës, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve i ZRrE-së ka analizuar rastin dhe paraqet këto arsyetime:
- Në bazë të nenit 20.4 të Ligjit Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë parapagimin për transmetuesin publik. Si një subjekt i tillë do të konsiderohen njësitë të cilat kanë një faturë për rrymë apo ndonjë faturë tjetër publike.
 - Sipas nenit 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 të liruar nga obligimi i cekur me lartë, përfshihen banorët e vendbanimeve ose pjesët e vendbanimeve të Kosovës ku mungon sinjali cilësor televiziv i rrjetit tokësor, dhe Familjet që janë përfshirë në listën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale si kategori e veçantë, përfshirë edhe ato që janë nën asistencë sociale.
 - Konsumatori nuk i ka plotësuar kushtet e nenit 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës.
7. Më 21.06.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që **të refuzoj** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në pikën 6 të këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, konsumatori ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjyqin Kompetent të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRrE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Naim Bejtullahu, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar